

Statistikat e transportit

Mars 2019

Tiranë, më 30 Prill 2019: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Mars 2019 është 429 mijë ton, duke u rritur 46,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Në tremujorin e parë 2019, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.036 mijë ton, duke u rritur me 10,3 % krahasuar me vitin 2018.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.733 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 5,3 % krahasuar me Mars 2018.

Në tremujorin e parë 2019, ky volum është 4.246 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 38,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë 2018.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Mars 2018	293.037	1.645	174
Mars 2019	429.394	1.733	200
Ndryshimi vjetor (%)	46,5	5,3	14,9
Janar- Mars 2018	939.244	3.067	523
Janar- Mars 2019	1.036.275	4.246	565
Ndryshimi vjetor (%)	10,3	38,4	8,0

* Përfshin mallrat dhe postën

Në tremujorin e parë 2019, me ajër janë transportuar 565 ton mallra duke u rritur 8,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2018

Numri i fluturimeve të kryera, në Mars 2019 është 1.856 duke shënuar një rritje me 3,0 %, ndaj Mars 2018.

Për publikim 30/04/2019

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Mars 2018	19	1.802	9.731
Mars 2019	19	1.856	10.399
Ndryshimi vjetor (%)	-	3,0	6,9
Janar- Mars 2018	19	5.424	26.277
Janar- Mars 2019	19	5.523	28.344
Ndryshimi vjetor (%)	-	1,8	7,9

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Mars 2019 është 49.776 pasagjerë. krahasuar me Mars 2018, ky tregues është rritur 9,3 %. Në tremujorin e parë 2019, kanë udhëtuar me linjë detare 151.506 pasagjerë, duke u rritur me 1,5 %, krahasuar me një vit më parë.

Në muajin Mars 2019, transporti ajror i pasagjerëve zë 79,8 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në tremujorin e parë 2019 është 610.332 pasagjerë duke u rritur me 8,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Mars 2018	3.475	45.560	192.162
Mars 2019	3.993	49.776	212.034
Ndryshimi vjetor (%)	14,9	9,3	10,3
Janar- Mars 2018	7.881	149.248	560.868
Janar- Mars 2019	9.220	151.506	610.332
Ndryshimi vjetor (%)	17,0	1,5	8,8

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Mars 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është miliardë lekë dhe 52,4 % e tyre u transportua me det.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 220 miliardë lekë dhe 52,8 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave


Në Mars 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 59,9 %, me rrugë 38,3 % dhe me ajër 0,2 %.

Mallrat e eksportuara me det, në Mars 2019, janë rritur me 4,6 % dhe me rrugë janë rritur me 21,3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, mallrat e eksportuara me det zënë 62,2 %, me rrugë 36,0 % dhe me ajër 0,3 %.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 9,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Mars 2019



Importet e mallrave


Në Mars 2019, mallrat e importuara me det zënë 48,7 %, me rrugë 43,5 % dhe me ajër 3,5 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë në Mars 2019, janë rritur me 89,8 % dhe me rrugë janë rritur me 3,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Në tremujorin e parë të 2019, mallrat e importuara me det zënë 48,2 %, me rrugë 41,9 % dhe me ajër 3,4 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në tremujorin e parë të vitit 2019, janë rritur me 0,8 % dhe me rrugë janë rritur me 2,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Mars 2019



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë